



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 3665 Prot

Peshkopi, më 21.07.2022

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.55 Datë:  
**15.07.2022**

“Për një shtesë në zërin e investimeve në Buxhetin e Bashkisë Dibër”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.694/1.prot.

Peshkopi, më 25.07.2022

Lënda : Per vendimin nr. 55, datë 15.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër


Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.55, date 15.07.2022 “Për një shtesë në zërin e investimeve në buxhetin e Bashkisë Dibër.”, vendosa :

Miratimin në parim të këtij vendimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e financës e probleme të ngjashme me to, veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturava të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-akte të tilla.

Në kuptim të nenit 13, pika 5 e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë subjekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi , sidomos per rastet e respektimit të disziplines financiare. sikunder veprimet juridikore financiare që do të kryhen nga zbatimi i aktit administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi .





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DIBËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr. 55 Datë 15/07/2022**

**“ Për një shtesë në zërin e investimeve në Buxhetin e Bashkisë Dibër”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 datë 21.01.2022, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **15.07.2022** me 18 vota pro, 2 kundër dhe 0 apstenim

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtesës së zërit të fondit të investimeve për objektet: Sistemin Asfaltim i rrugës “Lushe”, Sistemin Asfaltim i sheshit të Fshatit Cetush dhe Rikonstruksionin e shkollës 9-vjecare të fshatit Lishan, Bashkia Dibër”; si më poshtë

**2. Të pakësohet:**

Gr 0,0 Tit.6260 Kap.1 Art. 602 në vlerën prej 5.000.000 lekë e parashikuar për blerje dru zjarri për popullatën.

Gr 0,0 Tit.6260 Kap.5 Art. 602 në vlerën prej 5.000.000 lekë e parashikuar për blerje dru zjarri për popullatën.

**Të shtohet:**

Gr 0,0 Tit.4520 Kap.1 Art.231 në vlerën prej 5.000.000 për objektin “Sistemin Asfaltim i rrugës “Lushe”.”

Gr 0,0 Tit.4520 Kap.5 Art.231 në vlerën prej 1.000.000 lekë për objektin “Sistemin Asfaltim i rrugës “Lushe”.

Gr 0,0 Tit.4520 Kap.5 Art.231 në vlerën prej 1.200.000 lekë për objektin “Sistemin Asfaltim i sheshit të fshatit Cetush”.

Gr 0,0 Tit.9120 Kap.5 Art.231 në vlerën prej 1.500.000 lekë për objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare fshatit Lishan”.

Gr 0,0 Tit.9120 Kap.5 Art.231 në vlerën prej 1.300.000 për objektin “Investime në kopshte të Bashkisë Dibër”.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**Kryetar Këshilli**



---

Adresa: | Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: [bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) tel: 0035521822935